



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 107 Prot

Tiranë, më 05.07, 2011

VENDIM Nr. 166, dt. 05.07.2011

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 05.07.2011, mbasi shqyrtoi "Kërkesën për miratim sondazhi arkeologjik në sheshin e ndërtimit në pronë të Familjeve Faik Luku dhe Halit Dehari për objektin "Godinë banimi dhe shërbimi 9 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë", Lagjja Nr. 5, Rruga "Mujo Ulqinaku", zona arkeologjike "B" – (Durrës "Subjekti "TOSKA" sh.p.k),

VENDOSI:

- I. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës, të kryejë sondazhin arkeologjik në sheshin e ndërtimit në adresën e mësipërme.
- II. Subjekti "TOSKA" sh.p.k, të lidhë kontratën dypalëshe me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik për kryerjen e sondazhit arkeologjik.
- III. Raporti i sondazheve arkeologjike të paraqitet për miratim në mbledhjen e radhës të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.
Sondazhet të qëndrojnë të paprekura deri në marrjen e miratimit me shkrim nga KKA.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

SUZANA TURKU

ZV.MINISTRE



SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK